



Prishtine, data: 16.03.2021

KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE - Ne baze te Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, ne lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 4835 dt. 31.10.2017 mbi shqiptimin e gjobës administrative ndaj: **Osman Thaqi** person fizik me nr. personal 1173065970 me adresë Llapushnik, Komuna Glllogoc, merr këtë vendim :

AKTVENDIM

1. Dorëzimi i mëtejshme i të gjitha shkresave dhe parashtrësive për **Osman Thaqi** person fizik me nr. personal 1173065970 me adresë Llapushnik, Komuna Glllogoc, tani e tutje do të bëhet me afishimin e tyre në tabelën e shpalljeve në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit të afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

Arsy etim

Ndaj Gëzim Dragusha, me adrese Radoste, Komuna Rahovec, KPMM ka lëshuar Aktvendim me nr. 4835 dt. 31.10.2017.

Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt.31.10.2017 dhe me dt.26.02.2021 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

Këshilla Juridike:

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .



Ramiz Krasniqi

Dreitor

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF SERBIA
KOMISIONI PRAVILNIK PER MINIERA DUE MINIERALE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA RUĐHWE MINERAL E
INDEPENDENT COMMISSION FOR MINES AND MINERALS

DALJE

DEPISEK _____ NR PROT
DEPISEK _____ BR. PROT
DEPISEK _____ NR PROT

1083

REKRETI FAJHVE
SHUJ SHKUT
SH. OF DALJE _____

DD MM VVVV
DD MM GG GG
DD MM VVVV

16032021

PRISHTINE/A



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE (KPM) në pajtim me nenin 79 paragrafët 4 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, nxjerr këtë:

AKTVENDIM

1. Ndaj: **Osman Thaqi** person fizik me nr. personal 1173065970 me adresë Llapushnik, Komuna Glogoc.
2. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 shqiptohet gjoba administrative për zhvillimin e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar pa posedimin e Lejes për Aktivitete të Veçanta – Thërmues me Seperacion në shumën prej **5,000.00 € (pesë mijë euro)**.
3. Pala ka 15 ditë afat nga data e hyrjes në fuqi të këtij aktvendimi që të kryejë pagesën e shumës së përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit në këtë xhirollogari **1000430070005950**.

Arsyetim

Gjatë inspektimit të aktiviteteve të jashtëligjshme minerare me datën 19.10.2017, Inspektorati i Minierave i KPM-së, në bazë të autorizimeve dhe obligimeve që dalin nga Ligji i Minierave ka konstatuar se personi fizik Osman Thaqi është hasur duke ushtruar aktivitet të jashtëligjshëm minerar në objektin minerar të Thërmuesit me Seperacion. Inspektimi është bërë në lokacionin e objektit minerar në Thërmuesin me Seperacion në Siboc Komuna e Obiliqit me asistimin e Policis, Stacioni Policor në Obiliq. Gjatë inspektimit Inspektorët e Minierave kanë konstatuar se personi fizik Osman Thaqi ka kryer aktivitet të jashtëligjshëm minerar në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet si dhe Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, duke e përkufizuar edhe lokacionin me koordinata ku ishte duke ushtruar aktivitet të jashtëligjshëm minerar. Lloji i mineralit që jeni hasur duke e thërmuar dhe seperuar në mënyr të jashtëligjshme është qymyr.

Inspektorët e Minierave kanë konstatuar se personi fizik Osman Thaqi aktivitetin e operimeve të jashtëligjshme minerare e zhvillonte në lokacionin me këto koordinata:

Nr.	Y	X	Z (m)
1.	7499312	4728138	647
2.	7499303	4728114	634
3.	7499284	4728111	635
4.	7488276	4728145	639

4835

31.10.2017

Në lidhje me këto koordinata personi fizik Osman Thaqi nuk posedon Leje për Aktivitet të Veçanta – Thërmues me Seperacion të lëshuar nga organi kompetent i KPM-së.

Makineria e angazhuar në kryerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm minierar ishte:

- Thërmuesi me Seperacion, AMMANN.
- Luga ngarkuese SI. 18-C.
- Luga ngarkuese me vemëza, AMMANN 955.
- Kamion Volvo 290 FM7 viti i prodhimit 1999 me tabela 01-219-DP.
- Kamion Mercedes Actros 1840 viti i prodhimit 1999, me tabela 649-KS-735.


Personi fizik Osman Thaqi është urdhëruar me anë të urdhëresës të lëshuar nga Inspektorët në datën e inspektimit që menjëher të ndërprej aktivitetin e jashtëligjshëm minierar.

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka marrë njoftimin për nxjerrjen e aktvendimit. Ankimi administrativ i drejtohet Komisionit për Ankesa të KPMM-së.

Aktvendimi t'i dergohet:

- Arkivës së KPMM-së.
- Departamentit të Finacave të KPMM-së,
- Palës.



Ramiz Krasnqi
Drejtör
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale